

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**Keshilli i Ministrave**

**VENDIM**  
**Nr.404, date 19.6.2004**

**PER KRITERET E DHENIES DHE KOHEZGJATJEN E PUSHIMEVE NE RASTE TE VEÇANTA, PER USHTARAKET AKTIVE TE FORCAVE TE ARMATOSURA TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te pikave 5 e 6, te nenit 32, te ligjit nr.9210, date 23.3.2004, "Per statusin e ushtarakut te Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise", me propozimin e ministrit te Mbrojtjes, Keshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ushtaraket aktive te Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise, perveç pushimeve te parashikuara ne akte te tjera ligjore dhe nenligjore, kane te drejten e pushimit te paguar edhe per rastet e mepostme:

- Martese e ushtarakut    5 dite
- Martese e femijes    3 dite
- Lindje te femijes, per baballaret    3 dite
- Vdekje e prinderve, prinderve te bashkeshortit/es, gjysherve, bashkeshortit/es, femijeve, vellezerve, motrave    5 dite
- Nderrim banese brenda rrethit    2 dite
- Semundje te renda te femijeve, prinderve, bashkeshortit/es, te vertetuara me raport mjekesor    2 dite
- Pergatitje dhe mbrojtje e titujve pasuniversitare, per punen qe kryejne    deri 15 dite
- Nderrim i vendbanimit te perhershem, per shkak te detyres    5 dite
- Kur peson demtime nga fatkeqesite natyrore    5 dite
- Ne perfundim te misioneve paqeruajtese jashte shtetit:

deri ne 3 muaj    5 dite  
deri ne 6 muaj    10 dite  
mbi 6 muaj    15 dite

- Kur thirret nga organet e drejtesise, si pale, deshmitar apo ekspert    rast pas rasti

2. Ushtaraket aktive te Forcave te Armatosura kane te drejte qe ne raste te veçanta, te kerkojne leje pa te drejte page deri ne 45 dite brenda nje viti kalendarik, kur kjo nuk cecon gatishmerine luftarake dhe punen.

Leja per pushim te papaguar jepet per:

- vdekje dhe martese te pjesetareve te familjes kur i nevojiten me shume se koha e percaktuar ne piken 1 te ketij vendimi;
- perkujdesje ndaj pjesetareve te familjes;
- fatkeqesi ne familje;

- çeshtje personale, per femijet, bashkeshortin/en apo prinderit.

3. Leja per pushim te paguar dhe te papaguar jepet nga eprori direkt pas paraqitjes se kerkeses nga i interesuari dhe me miratimin e eprorit direkt ne hierarkine e autoritetit te institucionit/njesise perkatese.

4. Ushtaraket aktive, kur punojne a sherbejne ne vende pune, ne kushte te njejta, ne dege apo sektore te tjere jashte strukturave te Forcave te Armatosura, perfitojne te gjitha te drejtat per kohen e pushimit, si punonjesit e ketyre degeve apo sektoreve.

5. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes per zbatimin e ketij vendimi.

6. Vendimi nr.258, date 22.5.1995, i Keshillit te Ministrave, "Per rregullimin e kohes se punes dhe te pushimit per ushtaraket aktive te sistemit te Ministrise se Mbrojtjes", shfuqizohet.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI  
FATOS NANO**

**MINISTRI I MBROJTJES  
PANDELI MAJKO**